

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4886/1 datë 21.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-5193/8 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, miratoi si vijon:

### **Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, për shkak të shkëljes së nenit 51 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv transmetuar më 4 nëntor 2024, nuk ka ofruar informacionin që duhet të vihej në dispozicion të përdoruesve.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4886/1 datë 21.11.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1

2. URDHËROHET SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cituer në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

### **Arsyetim**

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për media, LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesit të medias (radio transmetuesit) ndërmerr masë - vërejtje publike në rastet kur ka shkëlje ose shkëlje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale duhet t'u ofrojnë përdoruesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat e mëposhtme: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual, respektivisht emrin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar të identifikimit personal (avizo, logon dhe të ngjajshme); adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audioviziv; të dhënat për kontakt të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audioviziv (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose të ueb-faqes, personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur dhe për organin rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 21 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorimin) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, transmetuar më 4 nëntor 2024, në nivel lokal ku është konstatuar shkëlje e nenit 51 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Gjegjësisht, mbikëqyrja ka konstatuar se me datë 4 nëntor 2024, SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve, respektivisht nuk ka ofruar qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat e mëposhtme: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual; adresën e selisë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual; të dhënat për kontakt (numër telefonit, e-mail adresë dhe/ose të ueb-faqes; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4886/1 datë 21.11.2024, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë me datë 25.11.2024, dërgoi Shkresë ark.nr.10-4886/1 datë 25.11.2024, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4886/1 datë 21.11.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi me datë 27.11.2024. Në afatin e paraparë SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 25.11.2024, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi që SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4886/1 datë 21.11.2024. dhe Konkluzionin ark.nr.02-5193/8 datë 26.12.2024, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 25.12.2024, ka miratuar Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon puna e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi, transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4886/1 datë 21.11.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.